

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
T&G SHPK.**

Sot me date 11 Janar 2021 , Une i nënshkruari **ANDI GJIKNURI** , i biri i Thodhorit, i datëlindjes 02.04.1980, lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) nr. 033812595,

me vullnetin tone te plote dhe lire, përmes ketij akti, themeloj një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar ne përputhje me legjislacionin ne fuqi te Republikës se Shqipërisë dhe sipas kushteve te përcaktuara ne këtë Akt Themelimi dhe ne Statutin përkatës.

**Neni 1**

**Themelimi dhe Emërtimi**

Shoqëria me përgjegjësi te kufizuar **T&G Shpk.**, (me poshtë e quajtur "*Shoqëria*") themelohet ne përputhje me ligjin shqiptar nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**Neni 2**

**Personaliteti Juridik**

Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit ne Tirane, Shqipëri.

**Neni 3**

**Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria e cila ka organizimin si një shoqëri *holding*, do te jetë zotëruese e kuotave te një ose disa shoqëri te tjera dhe do te ofroje asistence për shoqëritë e zotëruara ne mënyre te drejtpërdrejtë ose te tërthorte nga vete Shoqëria apo ortaket e saj (ne vijim *shoqëritë e grupit*), ka për objekt dhe qellim te saj ushtrimin e aktiviteteve, qe do te përfshijnë por nuk do te kufizohen ne sa me poshtë:

- Zotërimi dhe administrimi i kuotave te shoqërive të kontrolluara ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.
- Blerjen e aseteve dhe shitjen e tyre
- Koordinimi teknik, administrativ, financiar dhe organizativ te *shoqërive te grupit*.
- Dhënie e garancive të të gjitha llojeve ne favor te *shoqërive te grupit* dhe dhënia shërbimeve te analizës, koordinimit, studimeve te tregut, marketingut, etj.
- Orientim ne vendosjen e objektivave dhe strategjive, koordinimin e aktiviteteve te shoqërive te grupit, te vendose objektivat financiare, te kontrolloje sjelljen dhe efektivitetin financiar, dhe ne përgjithësi, menaxhimin dhe kontrollin financiar si dhe mbështetjen ne këtë drejtim te *shoqërive te grupit*.



- Këshillim i vazhdueshëm për aktivitetet tregtare te *shoqërive te grupit*, qe do te përfshijë por nuk do te kufizohet ne studime dhe asistence për themelimin dhe ushtrimin e aktiviteteve tregtare ne Shqipëri dhe jashtë saj, ne përputhje me legjislacionin mbi shoqëritë tregtare ne Republikën e Shqipërisë, asistence ne hartimin e statuteve, mbajtjen e librave te shoqërive tregtare dhe përbushjen e detyrimeve pranë organeve përkatëse, asistence ne përgatitjen e planeve te biznesit, asistence ne përgatitjen dhe zbatimin e programeve te ristrukturimit dhe uljes se kostove, asistence ne planifikimin dhe zbatimin e operacioneve ekonomike te jashtëzakonshme te shoqërive (ristrukturime, bashkime, ndarje, zmadhime kapitali, blerje sipërmarrjesh ose degësh te tyre; transformime, mbyllje dhe likuidim te shoqërise).
- Këshillim financier duke përfshire por pa u kufizuar ne analizën financiare për strategjitet e zhvillimit, përgatitjen e planeve te financimit, këshillim dhe asistence ne operacionet e kredisë, studim dhe kërkim burimesh financiare me kushte lehtësuese, asistence ne operacionet e investimeve te paluajtshme, dhe fusha te tjera qe lidhen me aktivitetin e *shoqërive te grupit*.
- Asistence ne kërkimin, punësimin e personelit, dhe vodosja ne dispozicion te *shoqërive te grupit* te personelit te kualifikuar sipas nevojave.
- Studime dhe këshillim ne fushën e inxhinierisë, se projektimeve civile e industriale dhe analizave te tregu si dhe këshillim ne çdo sektor dhe fushe qe lidhet dhe mbështet ne mënyrë te drejtpërdrejtë ose te tërthortë ose indirekte veprimtarinë ekonomike te *shoqërive te grupit*.
- Me qëllim realizimin e objektit te aktivitetit te saj, Shoqëria mund te kryeje çdo veprimitari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji pre realizimin e objektit te aktivitetit te saj.

**Neni 4****Selia**

- 4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Rr "Kavajes,Qendra Sun Tower,Kati 8, Apartamenti nr.30, Tirana, Albania
- 4.2 Shoqëria mund te krijoje dege, seli dytësore dhe te kryeje aktivitet ne vende te tjera, brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë, me vendim te administratorit te Shoqërisë.

**Neni 5****Kohëzgjatja**

- 5.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një kohëzgjatje te pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar te Republikës se Shqipërisë.
- 5.2 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do te përcaktohet me vendim te asamblesë se ortakeve ne përputhje me dispozitat e ketij Akti Themelimi, Statutit te Shoqërisë dhe legjislacionin ne fuqi.

**Neni 6**

### Kapitali

6.1 Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (nje qind mijë) ne vlore monetare.

6.2 Ne përputhje me piken 6.1 me sipër kapitali themeltar i Shoqërisë eshte 100.000 (nje qind mijë) Leke, i ndare ne 1 kuota me vlore 100.000 (nje qind mijë) Leke.

### Neni 7

#### Ortaket

7.1 Ortaket e Shoqërisë janë si vijon: **Z. Andi Gjiknuri**, zotërues i 1 (një) kuote me vlore 100.000 (nje qind mijë) Leke te barasvlershme me 100% (pesëdhjetë përqind) te kapitalit te Shoqërisë;

7.2 Kuotat janë te transferueshme dhe mund te transferohen ne çdo kohe ne përputhje me kushtet dhe afatet qe përcaktohen ne ligjin shqiptar dhe ne Statutin e Shoqërisë.

### Neni 8

#### Administrimi i Shoqërisë

- 8.1 Pasuria, veprimtaria dhe aktiviteti i Shoqërisë do te administrohet nga nje (1) administrator.
- 8.2 Administratori do te përfaqësojnë Shoqërinë ne përputhje me kompetencat dhe afatin e emërimit qe i janë dhëne ne përputhje me ligjet e Republikës se Shqipërisë, Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë.
- 8.3 Administratoret e pare te Shoqërisë te emëruar për një afat 5 (pese) vjeçar nga data e regjistrimit te Shoqërisë ne Regjistrin Tregtar do te jene:

**Andi Gjiknuri**, i biri i Thodhorit, i datëlindjes 02.04.1980, lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për te vepruar, mbajtës i letërnjoftimit (ID) nr. 033812595

### Neni 9

#### Viti Ushtrimor

- 9.1 Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti kalendarik.
- 9.2 Përjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon ne datën e themelimit te Shoqërisë dhe përfundon me 31 Dhjetor te ketij viti.

Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet ne 4 (katër) origjinale ne gjuhen shqipe.

#### ORTAKU

**Andi Gjiknuri**

*Andi Gjiknuri* *J.*